



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 566/Prot

Tiranë, më 31/01/2020

URDHËR

Nr. 531, Datë 31/01/2020

PËR

**NGRITJEN E TASK-FORCË PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT TË PËRHAPUR
NGA CORONAVIRUSI I RI**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.15 datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Task-Force për parandalimin e infeksionit të përhapur nga coronavirus i ri, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me këtë përbërje:
 - a. Znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kryetar
 - b. Përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Anëtar
 - c. Përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik, Anëtar
 - ç. Përfaqësues të Qendrës Spitalore Universitare “Nëne Tereza”, Anëtar
 - d. Përfaqësues të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Anëtar
 - dh. Përfaqësues të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Anëtar
 - e. Përfaqësues i Departmantit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Anëtar
 - ë. Përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Anëtar
 - f. Përfaqësues i Urgjencës Kombëtare Mjekësore, Anëtar
 - g. Përfaqësues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Anëtar
2. Task- Force merr udhëzime nga Komiteti i Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri dhe dhe raporton në këtë Komitet.
3. Task- Force do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një periudhë 6 mujore.
4. Kryetari i Task-Force përgjigjet në çdo kohë para Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për ecurinë e zbatimit të masave për parandalimin e infeksionit të përhapur nga coronavirus i ri.
5. Kryetari i Task-Force është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të planit të masave, koordinimin ndërinstitutional dhe vendos për përforcimin e masave sipas shkallës së riskut.

6. Task - Force dërgon raporte periodike pranë Kabinetit të Ministrit, për veprimet e ndërmarra dhe ecurinë e procesit për parandalimin e infeksionit të përhapur nga coronavirus i ri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

